# AKT THEMELIMI
# I
# SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "B R I L A N T"SHPK

N E N I 1

Luan Çiba i biri i Hakikut, dtl 1964 banuesme lagjjen Drita Burrel, sot me date 1 shkurt 2000, ka vendosur te themeloje shoqerime me pergjegjesi te kufizuar " BRILANT" SHPK ne perputhje me ligjin per shoqerite tregtare.

N E N I 2

Shoqeria vepron ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e satatutit qe i bashkelidhen ketij akti themelimi.

N E N I 3

Emri i shqoerise eshte "BRILANT" SHPK

N E N I 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte : Kat 1 - Punime dhe sistemime , tarracime terrenesh etj; kat 2 - a,c,; Kat 3- a,b ndertime civile dhe ekonomike, Kat 4/a - ndertim rruge kat V,IV, b/ ndertim rrug kat III,II,I dhe speciale (autostrada); c- Veshje me asfaltobeton te rrugeve(ndertim mbishtresa) si dhe sistemim dhe asfaltim sheshe . f-punime te mirembajtjes, sinjalizimit dhe vijezimit ne rruge, Kat 6/a- ndertim vepra arti te vogla deri ne 6m; Kat 8/b- Ndertim ujesjellesa e kanalizime, c- ndertim vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese g - Punime mbrojtjeje dhe sistemimi hidraulik; Kat 9 - a,b; Kat 10/a- rikonstruksion godina civile, ekonomike, veshje fasadash etj. Kat 11- a, b punime karpentjerie; Kat 14/d - Mirembajtja zhvillimi i dekorit ne mejdise urbane; kat 13- c,d,e,f,g,h,i. Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem bujqesor industrial dhe ushqimor, bar kafe e restorant. Tregtim me pakice te karburanteve; Transport mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit per vete dhe te tretete.

N E N I 5

Qendra dhe selia e shqqerise eshte ne lagjjen "DRITA" qytetit Burrel.

N E N I 6

Kapitali themeltar i shqqerise eshte 400.000 leke.

N E N I 7

Kohezgjatja e veprimtarise se shqqerise eshte mbi 10 vjet.

N E N I 8

Administrator i shqqerise eshte ortaku i vetem LUAN ÇIBA

Tirane me 1 shkurt 2000

ORTAK I VETEM

/IIJAN ÇIBA /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
Nr 477 Regj.
Nr 22 Kol

## VERTETIM

Ne Tirane, sot date 01 shkurt 2000 ne zyren e noterise Tirane, perpara meje noteres u paraqit personalisht Luan Ç iba , madher me zotesi te plote juridike per te vepruar, me identitein e te cilit u garantova me pasaporten e tij personale nr U151989 i cili me cilesine e ortakut te vetem te SHPK "BRILANT" neshkrei me vullnet te lire dhe te plote kete akt themelimi dhe une noterj vertetoj sipas ligjit neshkrimin e tij.

N O T E R E
/Vjollca Skendo/



# S T A T U T
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "BRILANT" SHPK

## 1. Krijimi,forma,emertimi,objekti, selia dhe kohezgjatja e shoqerise

### N E N I 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufisuar "BRILANT" SHPK me qender ne lagjen Drita Burreleshte krijuar sipas akt themelimit qe i bashkengjitet ky statut i perpiluar dhe nenshkruar nga

1. Isen Çiba i biri i Hakikut, dtl 1964, banues ne Lagjjen "DRITA" Burrel.

### N E N I 2

Shoqeria e zhvillon veprimtari me tregtare ne Shqiperi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dhe me dispozitat e ketij statuti. Shoqeria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne gjykate.

### N E N I 3

Emertimi i shoqerise eshte "BRILANT" SHPK.

### N E N I 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: Kat 1-Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj. Kat 2 - a,c Kat 3- a,b ndertime civile dhe ekonomike, Kat 4/a- Ndertim rruge kat V,IV; b-ndertim rruge kat III,II, I dhe speciale (autostrada). c-veshje me asfaltobeton te rrugeve,(ndertim nbishtrese si dhe sistemimin e asfaltim sheshesh) Punime te mirembajtj sinjalizimit, dh vijezimit ne rruge. Kat 6/a - Ndertim vepra arti te vogla deri ne 6m. Kat 8/b - Ndertim ujesjellesa e kanalizime, c- ndertim vepra kullimi, ujitje teke, e impiante vaditese. ga Punime mbrojtje dhe sistemimi hidraulik Kat 9 - a,b Kat 10/a - rikonstruksion godina civile ekonomike, veshje fasadash etj. Kat 11 - a,b - punime karpentjerie. Kat 14/d - Mirembajtja zhvillimi, i dekorit ne mjedise urbane. Kat 13 - c,d,e,f,g,h,i. Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem bujqesor industrial dhe ushqimor, bar kafe restorant. Tregtim me pakice t karburanteve. Transport mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit per vete dhe te tretet.

### N E N I 5

Qenda e shoqerise eshte ne qytetin e Burrelit Lagjja Drita. Shoqeria e ka selime ne lagjjen "DRITA" qyteti Burrel. shoqeria ka vulen dhe emrin e vet.

### N E N I 6

Kohesgjàtja e shoqerise eshte e percaktuar mbi 10 vjet duke fillum nga dita e regjistrimit te saj ne gjykate. Kjo periudhe, mund te shkurtohet ne rast se shoqeria prishet perpara kohe.

## II KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTI DHE PJESET E KAPITALIT THEMELTAR.

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 400.000 leke.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi i ortakut te vetem.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme , ne rruge trashegimie, ne rast nderje pasurore midis bashkeshorteve dhe midis paraardhesve dhe pasardhesve.

NENI 10

Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen personave te trete me miratim te ortakut te vetem.

NENI 11

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar gjithmone duhet te vertetohet me akt noteriale.

## III MARRJA E VENDIMEVE ADMINISTRIMI KOMPETENCAT DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 12

Te gjithe vendimet e shoqerise merren nga ortaku i vetem.

NENI 13

Shoqeria administrohet nga administrtaore qe duhet te jete person fizik ose mund te jete ortak i vetem. Ne mbledhje n e pa re te shoqerise emerohet administrater zoti LUAN ÇIBA. Administratori ka te gjithe kompetencat per te kryer te gjithe veprimet e adm istrimit ne interes te shoqerise, dhe ne emer te saj neëermjet komptencave qe i jane perca ktuar ne kete statut. Administrteri emerohet dhe shkarkohet me miratim te ortakut te vetem. Emerimi i tij behet per tre vjet financiar. me perjashtim te rasteve te doreheqjes apo te shkarkimit per pa aftesi.

NENI 14

Administarotori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rasteve, Ndaj shoqerse apo ndaj te treteve. Per shkeljet e ligje ve e dispozitave te ketij statuti apo per faje gjate administratimit t- te shoqerise.

NENI 15

Disa nga kompetencat qe i jepen administraterit jane:

- Te siguroje drejtimin e mire te shoqerise.
- Te administrroje pasurine e shoqerise.
- Te perfaqesoje shqoerine ne marredhejet me te tretet.
- Te perfaqesoje shoqerine perpara organeve gjyqsore ose autorisc personave te tjere kompetente.

- Kryen veprime juridike, ne emer dhe per llogari te shoqerise me te tretet si : lidh kontrata, ben celje te kredive, kryen veprime te ndryshm bankare, etj. brenda limitit qe e lejon ortaku i vetem.

NENI 16

Kontrolli i shoqerise kryhet nga eksperte kontabel i cili emerohet dhe shkarkohet nga ortaku i vetem.

IV. VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE

NENI 17

Çdo vit financiar fillon me date 1 janar dhe perfundon me date 31 dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar diten e theme limit si person juridik.

NENI 18

Llogarite vjetore, invendari, raporti mbi veprimtarine e vitit financiar te hartuara nga administratori nga eksperti kontabel i autorisua miratohet nga ortaku i vetem. Bilanci vjetor i veprimtarise se shoqerise nxirret brenda 31 marsit pasardhes.

NENI 20

Fitimet neto, te realizuara nga veprimtaria e shoqerise mbasi zbriten te gjitha shpenzimet e kryera , ortaku i vetem vendos qellimin e perdorimit: Per investim, nxitjen ekonomike dhe reklame tregtare et

NENI 21

Shoqeria ka te drejten e perdorimit lirisht te fitimeve , dhe te disponimit lirisht te pasurise se saj, ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise qe kryhet.

NENI 22

Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shqoqerise ajo i mbulon nga fondi rezerve , ose nga shumat suplementare.

NENI 23

Shoqeria gezon te gjithe te drejtat per mbrojtjen e pasurive te saj nga legjislacioni ne fuqi.

V PUNESIMET NE SHOQERI

NENI 24

Per punonjesit QE do te punesohen maredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen nepermjet kontrates se punes, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

**N E N I 25**

Shoqeria merr persiper te derdhe rregullisht te gjithe detyrimet gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesuarve te saj ne organet kompetente perkatese ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

**VI PRISHJA E SHOQERISE LIKUJDIMI**

**N E N I 26**

Shoqeria prishet perpara kohe kur:

Aktiviteti i saj ekonomik per disa vjet radhasi eshte me humbje.

Per arsye te parashikuara ne ligj.

Ne çdo rast tjeter me vendim te ortakut te vetem.

**N E N I 27**

Shoqeria hyn ne proçesin e likujdimit, qe ne momentin e marrjes se vendimit per prishjen e saj. per kryerjen e ketij proçesi ortaku i vetem emeron nje ose dy likujdatore, te cilet i paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivit dhe te pasivit te shoqerise

**VII KUSHTE TE TJERA**

**N E N I 28**

Te gjithe vendimet e ortakut te vetem regjistrohen ne liber te veçante, qe mbahet ne seline e shoqerise.

**N E N I 29**

Per te gjithe mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtaris se shoqerise dhe qe nuk zgjidhen ne mirekuptim organi kompetent per zgjidhjen e tyre eshte gjykata e rrethit Tirane.

**N E N I**

Ky statut eshte redaktuar ne Tirane sot date 1 shkurt 2000.

Per SHPK "BRILANT"

ORTAKU i VETEM

/LUAN ÇIBA /

REPUBLIKA E SHQIPERSI

DHOMA E NOTERVE TIRANE

Nr 478 Regj.

Nr 23 Kol

**V E R T E T I M**

Ne Tirane, sot date 1 shkurt 2000 diten e marte ne zyren e noterise Tirane , perpara meje noteres Vjollca Skendo u paraqit personi i si

sht LUAN ÇIBA

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE

KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE PROFESIONALE N. 0850/3

PULLE TAKSE 50 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR 117 REP DT 11.01.2000
VERTETIM
VERTETOHET NJESIA
ME ORIGJINALIN
NOTER HALIL SINANI

# L I C E N S E.

Shoqeria private me emertimin " **A M F O R A** "

Me adrese ne Burrel

Me drejtues teknik z. **Skender Bukaci, Liman Gjoka, Rifat Minxhozi.**

Me drejtues ligjor Z. **Liman Gjoka**

rregjistruar ne regjistrin themeltar te ndermarrjeve per zbatim dhe nga data 02.11.1999. per kategorite e specifikuara te punimeve:

Per zbatim:

| | | |
|---|---|---|
| Kat. 1 | | - punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj |
| Kat. 2 | | - a, c |
| Kat. 3 | | - a, b ndertime civile dhe ekonomike |
| Kat. 4/a | | - ndertim rruge kat V.IV |
| | b | - ndertim rruge kar. III, II, I dhe speciale (autostrada ) |
| | c | - veshje me asfaltobeton te rrugeve (ndertim mbishtrese) si dhe sistemim e asfaltim sheshe |
| | f | - punime te mirembajtjes, sinjalizimit dhe vijezimit ne rruge |
| Kat. 6/a | | - ndertim vepra arti te vogla deri 6 m |
| Kat. 8/b | | - ndertim ujesjellsa kanalizime |
| | c | - ndertim vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese |
| | g | - punime mbrojtjeje dhe sistemimi hidraulik |
| Kat. 9 | | - a, b |
| Kat.10/a | | - rikonstruksion godina civile, ekonomike, veshje fasadash etj |
| Kat.11 | | - a, b punime karpentjerie |
| Kat.14/d | | - mirembajta, zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane |
| Kat.13 | | - c, d, e, f, g, h, i |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE

**BESNIK DERVISHI**

**D R E J T O R**

**Shenim: Kjo license eshte e vlefshme deri me daten 02.11.2001**